

UDHËZIM
Nr. 9, datë 21.2.2025

**PËR RREGULLAT PËR MASAT E VEÇANTA TË KONTROLLIT PËR TË
PARANDALUAR HYRJEN DHE PËRHAPJEN BRENDË TERRITORIT TË
VENDIT TË BRUMBULLIT TË PATATES *EPITRIX CUCUMERIS* (HARRIS),
EPITRIX SIMILARIS (GENTNER), *EPITRIX SUBCRINITA* (LEC.) DHE *EPITRIX
TUBERIS* (GENTNER)¹**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në pikën 3, të nenit 8, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1

Dëmtuesit e specifikuar *Epitrix cucumeris* (Harris), *Epitrix papa* sp. n., *Epitrix subcrinita* (Lec.) dhe *Epitrix tuberis* (Gentner)

Epitrix cucumeris (Harris), *Epitrix papa* sp. n., *Epitrix subcrinita* (Lec.) dhe *Epitrix tuberis* (Gentner), më tej “dëmtuesit e specifikuar”, nuk lejohen të hyjnë ose përhapen brenda territorit të vendit.

Neni 2

Hyrja e zhardhokëve të patates brenda territorit të vendit

1. Zhardhokët e *Solanum tuberosum* L., duke përfshirë ato të destinuara për mbjellje, në vijim “zhardhokët e patates”, me origjinë nga vendet e tjera ku dihet se janë të pranishëm një ose më shumë nga dëmtuesit e specifikuar, mund të hyjnë në territorin e vendit vetëm nëse ata plotësojnë kërkesat specifike të importit, siç përcaktohet në pikën 1, të seksionit 1, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkesat me zhardhokë patateje në import inspektohen nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) në përputhje me procedurat e pikës 5, të seksionit 1, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 3

Lëvizja e zhardhokëve të patates brenda territorit të vendit

1. Zhardhokët e patates me origjinë nga zonat e shënuara brenda territorit të vendit, të krijuar në përputhje me nenin 7 të këtij udhëzimi, të ambalazhuar brenda këtyre zonave ose në objektet e përmendura në nenin 5 të këtij udhëzimi, mund të lëvizin brenda territorit të vendit vetëm nëse plotësojnë kushtet, siç përcaktohet në pikën 1, të seksionit 2, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Zhardhokët e patates me origjinë nga një zonë e shënuar, mund të lëvizin nga kjo zonë e shënuar në një objekt ambalazhimi që plotëson kërkesat e nenit 5 të këtij udhëzimi, i cili është në afërsi të kësaj zone të përcaktuar, me kusht që të plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 2, të seksionit 2, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Zhardhokët e patates mund të ruhen në atë objekt.

Në rastin e nënparagrafit të dytë të kësaj pike, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) kryen veprimet e mëposhtme:

¹ Ky udhëzim përafron pjesërisht vendimin zbatues të Komisionit 2012/270/BE, të datës 16 maj 2012, në lidhje me masat emergjente për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda Unionit të *Epitrix cucumeris* (Harris), *Epitrix papa* sp. n., *Epitrix subcrinita* (Lec.) dhe *Epitrix tuberis* (Gentner).

a) monitorim intensiv i pranisë së dëmtuesit të specifikuar dhe i simptomave të infektimit nga ky dëmtues në zhardhokët e patates, nëpërmjet inspektimeve në kohën e përshtatshme mbi bimët e patates dhe sipas rastit, bimët e tjera bujtëse, duke përfshirë fushat ku këto bimë rriten, brenda një rrezeje prej 100 m të objektit të ambalazhimit;

b) aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me kërcënimin e dëmtuesve të specifikuar dhe masat e miratuara për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda territorit të vendit në afërsi të objektit të ambalazhimit.

2. Zhardhokët e patates, që hyjnë brenda territorit të vendit në përputhje me nenin 2, të këtij udhëzimi, nga vendet e tjera ku dihet se janë të pranishëm një ose më shumë nga dëmtuesit e specifikuar, mund të lëvizin brenda territorit të vendit vetëm nëse plotësojnë kushtet, siç përcaktohet në pikën 3, të seksionit 2, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 4

Kërkesat në lidhje me mjetet e transportit, ambalazhin, makineritë dhe mbeturinat e dheut

1. AKVMB-ja siguron që çdo mjet transporti dhe ambalazh, që është përdorur për transportimin e zhardhokëve të patates me origjinë në një zonë të shënuar përpara plotësimit të kërkesës së shkronjës “b”, të pikës 1, të seksionit 2, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi, është dezinfektuar dhe pastruar në mënyrën e duhur në rastet e mëposhtme:

a) përpara se të lëvizin jashtë zonës së shënuar; dhe

b) përpara se të largohen nga një mjedis ambalazhimi, siç përmendet në nënparagrafin e dytë të pikës 1, të nenit 3 të këtij udhëzimi.

2. AKVMB-ja siguron që makineritë e përdorura për të trajtuar zhardhokët e patates të përmendura në paragrafin 1 në një ambient ambalazhimi të përmendur në nënparagrafin e dytë të pikës 1, të nenit 3, të dezinfektohen dhe pastrohen në mënyrën e duhur pas çdo përdorimi.

3. AKVMB-ja siguron që mbeturinat e dheut ose materialet e tjera mbeturinash, që rezultojnë nga përmbushja e kërkesave të pikës 1, të nenit 3 dhe paragrafëve 1 dhe 2, të këtij neni, asgjësohen në një mënyrë të tillë që të sigurohet që dëmtuesit e specifikuar nuk mund të vendosen ose të përhapen jashtë një zone të shënuar.

Neni 5

Kërkesat në lidhje me objektet e ambalazhimit të vendosura jashtë zonave të shënuara

Objektet e ambalazhimit, të vendosura jashtë zonave të shënuara për këtë dëmtues të specifikuar dhe për trajtimin e zhardhokëve të patates me origjinë nga zona të shënuara, siç përmendet në nënparagrafin e dytë të pikës 1, të nenit 3, duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) janë të autorizuar nga AKVMB-ja për të ambalazhuar zhardhokët e patates me origjinë nga një zonë e shënuar; dhe

b) ruajnë, për një vit nga momenti i mbërritjes së zhardhokëve të patates në atë mjedis, të dhënat e zhardhokëve të patates të trajtuara, të cilat e kanë origjinën në zona të shënuara.

Neni 6

Vrojtimet dhe njoftimet në lidhje me dëmtuesit e specifikuar

1. AKVMB-ja kryen vrojtime zyrtare vjetore për praninë e dëmtuesve të specifikuar dhe simptomat e infektimit nga këta dëmtues në zhardhokët e patates dhe, sipas rastit, në bimë bujtëse të tjera, duke përfshirë fushat ku rriten zhardhokët e patates.

AKVMB-ja do t'i njoftojë strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve (SPMB-së) rezultatet e këtyre vrojtimeve deri më 30 prill të çdo viti.

2. Operatorët profesionistë duhet të njoftojnë menjëherë tek AKVMB-ja për çdo prani ose prani e dyshuar e një dëmtuesi të specifikuar, ose e simptomave të infektimit nga këta dëmtues në zhardhokët e patates.

Neni 7

Zonat e shënuara dhe masat që duhen marrë në këto zona

1. Kur rezultatet e vrojtimeve, të përmendura në pikën 1, të nenit 4, ose të dhëna të tjera, konfirmojnë praninë e një dëmtuesi të specifikuar ose të simptomave të infektimit nga këta dëmtues në zhardhokët e patates në një zonë, krijohet pa vonesë një zonë e shënuar e përbërë nga një zonë e infektuar dhe një zonë sigurie, siç përcaktohet në seksionin 1, të aneksit II, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

AKVMB-ja merr masa, e përcaktuar në seksionin 2, të aneksit II, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Në rastet e masave të marra në përputhje me pikën 1, AKVMB-ja publikon në faqen zyrtare listën e zonave të shënuara, informacionin për përcaktimin e tyre, duke përfshirë hartat që tregojnë vendndodhjen e tyre dhe një përshkrim të masave të zbatuara në ato zona të shënuara.

Neni 8

Dispozitat përfundimtare dhe hyrja në fuqi

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 janar 2025.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

ANEKSI I

Seksioni 1

Kërkesat specifike për hyrje brenda territorit të vendit

1. Pa cenuar dispozitat e përcaktuara në urdhrin nr. 113, datë 15.3.2022, “Për miratimin e rregullores për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve”, të ndryshuar, zhardhokët e patates me origjinë nga vendet e tjera ku dihet se janë të pranishëm një ose më shumë nga dëmtuesit e specifikuar, duhet të shoqërohen nga një certifikatë fitosanitare, siç përmendet në pikën 1, të nenit 19, të urdhrin nr. 113, datë 15.3.2022, “Për miratimin e rregullores për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve”, të ndryshuar, e cila përfshin nën titullin “Deklaratë shtesë” informacionin e përcaktuar në pikat 2 dhe 3.

2. Certifikata fitosanitare duhet të përfshijë informacionin në shkronjën “a” ose “b”:

a) zhardhokët e patates janë rritur në një zonë pa dëmtues të krijuar nga organizata kombëtare për mbrojtjen e bimëve në përputhje me standardet ndërkombëtare për masat fitosanitare përkatëse; ose

b) zhardhokët e patates janë larë ose pastruar, në mënyrë që të mos ketë mbetur më shumë se 0,1% e dheut ose i janë nënshtruar një metode ekuivalente të aplikuar posaçërisht për të arritur të njëjtin rezultat dhe për të hequr dëmtuesit e specifikuar dhe për të siguruar se nuk ekziston risk i përhapjes së dëmtuesve të specifikuar.

3. Certifikata fitosanitare, duhet të përmbajë sa vijon:

a) përfshin informacionin se zhardhokët e patates janë gjetur të pastra nga dëmtuesit e specifikuar dhe nga simptomat e infektimit nga këta dëmtues, në zhardhokët e patates dhe nuk

përmbajnë më shumë se 0,1% të dheut, në një ekzaminim zyrtar i kryer menjëherë përpara eksportit;

b) përfshin informacionin që materiali i ambalazhimit në të cilin importohen zhardhokët e patates është i pastër.

4. Kur jepet informacioni i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2, emri i zonës së mbrojtur nga dëmtuesit do të përmendet nën titullin “Vendi i origjinës”, për këta dëmtues të specifikuar.

5. Zhardhokët e patates për hyrje brenda territorit të vendit në përputhje me pikat 1 deri në 4 do të inspektohen në pikën e inspektimit kufitar (PIK) për të konfirmuar se ato plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga pikat 1 deri në 4 të këtij seksioni.

Seksioni 2

Kushtet për lëvizjen

1. Zhardhokët e patates me origjinë nga zonat e shënuara brenda territorit të vendit mund të lëvizin nga këto zona në zona jo të shënuara vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) zhardhokët e patates janë rritur në një vend të regjistruar prodhimi në përputhje me udhëzimin nr. 10, datë 28.4.2023, “Për formatin, kriteret dhe procedurat e regjistrimit të operatorëve profesionistë”;

b) zhardhokët e patates janë larë ose pastruar, në mënyrë që të mos ketë mbetur më shumë se 0,1% e dheut ose i janë nënshtruar një metode ekuivalente të aplikuar posaçërisht për të arritur të njëjtin rezultat dhe për të hequr dëmtuesit e specifikuar dhe për të siguruar që nuk ka risk të përhapjes së dëmtuesve të specifikuar;

c) materiali i ambalazhimit në të cilin lëvizen zhardhokët e patates është i pastër; dhe

ç) zhardhokët e patates shoqërohen nga një pasaportë bimore e përgatitur dhe e lëshuar në përputhje me urdhrin nr. 274, datë 5.5.2023, “Për procedurën, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë një operator për t’u miratuar për lëshimin e pasaportës bimore, si dhe rastet e heqjes së miratimit”.

2. Për lëvizjen e zhardhokëve të patates në objektin e ambalazhimit, siç përmendet në nënparagrafin e dytë të pikës 1, të nenit 3, përveç shkronjës “a”, të pikës 1, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) zhardhokët e patates janë rritur në fusha që i janë nënshtruar trajtimeve me insekticide kundër dëmtuesve të specifikuar në kohë të përshtatshme gjatë sezonit të rritjes;

b) janë kryer inspektime zyrtare para vjeljes, në kohën e duhur, në fushë dhe nuk është zbuluar asnjë dëmtues i specifikuar;

c) prodhuesi ka njoftuar paraprakisht AKVMB-në për qëllimin e tij për të lëvizur zhardhokët e patates në përputhje me këtë pikë dhe për datën e lëvizjes;

ç) zhardhokët e patates transportohen në objektin e ambalazhimit në automjete të mbyllura ose në ambalazhe të mbyllura dhe të pastra, në mënyrë të tillë që të sigurohet që dëmtuesit e specifikuar të mos mund të largohen ose të përhapen;

d) gjatë transportit të tyre në objektin e ambalazhimit, zhardhokët e patates shoqërohen nga një dokument që identifikon origjinën dhe destinacionin e tyre; dhe

e) menjëherë pas mbërritjes në ambientet e ambalazhimit, zhardhokët e patates i nënshtrohen trajtimit të përshkruar në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij seksioni.

3. Zhardhokët e patates të hyra në territorin e vendit në përputhje me seksionin 1 nga vendet e tjera ku dihet se një ose më shumë nga dëmtuesit e specifikuar janë të pranishëm, mund të zhvendosen brenda vendit vetëm nëse shoqërohen me pasaportë bimore të përmendur në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij seksioni.

ANEKSI II

ZONAT E SHËNUARA DHE MASAT NË PËRPUTHJE ME NENIN 5

Seksioni 1

Krijimi i zonave të shënuara

1. Zonat e shënuara përbëhen nga këto zona:
 - a) një zonë e infektuar, që përfshin të paktën fushat ku është konfirmuar prania e dëmtuesit të specifikuar ose janë konfirmuar simptomat e infektimit nga këta dëmtues në zhardhokët e patates, si dhe në fushat ku janë rritur zhardhokët e infektuar të patates; dhe
 - b) një zonë sigurie me një gjerësi prej të paktën 500 m nga kufijtë e zonës së infektuar; kur një pjesë e një fushe është brenda kësaj gjerësie, e gjithë fusha do të jetë pjesë e kësaj zone sigurie.
2. Në rastet kur disa zona sigurie mbivendosen ose janë gjeografikisht të afërta, do të krijohet një zonë e shënuar, e cila përfshin sipërfaqen e mbuluar me zonat e shënuara përkatëse dhe zonat ndërmjet tyre.
3. Kur përcaktohen zona e infektuar dhe zona e sigurisë, AKVMB-ja marr parasysh elementet e mëposhtme: biologjinë e dëmtuesve të specifikuar, shkallën e infektimit, shpërndarjen e bimëve bujtëse, të dhënat e vendosjes së dëmtuesve të specifikuar dhe kapacitetin e dëmtuesve të specifikuar për përhapen në mënyrë natyrale.
4. Nëse prania e një dëmtuesi të specifikuar ose simptomave të infektimit nga ky dëmtues i zhardhokëve të patates konfirmohet jashtë zonës së infektuar, kufiri i zonës së infektuar dhe zonës së sigurisë rishikohet dhe ndryshohet në përputhje me procedurat ligjore.
5. Për sa i përket një zone të shënuar, bazuar në vërtetimet e përmendura në pikën 1, të nenit 4, as dëmtuesit e specifikuar dhe as simptomat e infektimit nga ky dëmtues në zhardhokët e patates nuk janë hasur për një periudhë prej dy vjetësh, AKVMB-ja në bashkëpunim me SPMB-në konfirmon sipas procedurave ligjore se ky dëmtues nuk është më i pranishëm në atë zonë dhe se zona shfuqizohet si zonë e shënuar.

Seksioni 2

Masat në zonat e shënuara, siç parashikohet në nënparagrafin e dytë, të pikës 1, të nenit 5

Masat e marra nga AKVMB-ja në zonat e shënuara përfshijnë të paktën sa vijon:

1. Masat për çrrënjosjen ose kontrollin e dëmtuesve të specifikuar, duke përfshirë trajtimet dhe dezinfektimet, si dhe ndalimin e mbjelljes së bimëve bujtëse kur është e nevojshme;
2. Monitorim intensiv për praninë e dëmtuesve të specifikuar ose të simptomave të infektimit nga këta dëmtues në zhardhokët e patates nëpërmjet inspektimeve të duhura;
3. Mbikëqyrja e lëvizjes së zhardhokëve të patates jashtë zonave të shënuara.